

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE
NGA
VLORA JUPOLLI



UNIVERZI I PRISHTINË
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

MAJ,2023

EKSPOZE E TEMËS

LËVIZJET KRYENGRITËSE NË VILAJETIN E KOSOVËS 1908-1912

Mentor:

Prof. Dr. Ibrahim Gashi

Kandidati-ja:

Vlora Jupolli

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi bazë i këtij hulumtimi është analizimi i situatës së Vilajetit të Kosovës, ku në kuadër të këtij hulumtimi do të analizojmë formimin e vilajetit dhe ngjarjet që ndodhën në shekullin XIX.

Ngjarjet në Vilajetin e Kosovës gjatë vitit 1900-1908 në shekullin XIX i kishin acaruar akoma më tepër kundërthëniet midis shteteve imperialiste të Evropës që kishin ndikim të madh edhe në situatat politike të shqiptarët.

Ndër të tjerash ky punim synon të paraqesë rrethana në Vilajetin e Kosovës, organizimin e Lidhjes së Prizrenit më 1877-1908, përpjekjen për ringjalljen e Lidhjes së Pejës gjatë vitit 1878, mbledhjen popullore të krahinave të vendit dhe formimin e Lidhjes së shqiptarëve.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodologjia e hulumtimit e përdorur në këtë punim përbëhet nga metoda të kombinuara nga përshkruese, statistikore dhe përdorimi i të dhënave kryesisht sekondare. Për përgatitjen e punimit do të mblidhen të dhëna përmes përdorimit të literaturës shkencore dhe profesionale nga autorë të ndryshëm, si dhe përdorimit të botimeve nga ekspertë, revistave shkencore në fushën e historisë.

Literatura e referueshme për realizimin e këtij hulumtimi përbëhet kryesisht nga publikime zyrtare në internet, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe në Bibliotekën e Fakultetit Filozofik.

QËLLIMI

Qëllimi i këtij punimi master është që të studiohet roli dhe rëndësia e temës : Lëvizjet kryengritëse në Vilajetin e Kosovës 1908–1912 dhe në organizimin e Lidhjes së Prizrenit në vitet 1877-1908. Aty flitet për Vilajetin e Kosovës që është themeluar si Vilajeti i Prizrenit më 1868 dhe më pas si Vilajeti i Kosovës në vitin 1877. Përpyqja për ringjalljen e Lidhjes së Pejës është çështja gjatë vitit 1878. Gjatë kësaj periudhe ishte mbledhja popullore e krahinave të vendit dhe ishte formimi i lidhjes shqiptare. Nismën për thirrjen e Kuvendit të përgjithshëm e mori Komiteti i Stambollit në rrethanat e fshehtësisë së plotë, ndërsa vendi për mbledhjen e Kuvendit u caktua në Prizren. Ngjarjet në Vilajetin e Kosovës gjatë vitit 1900-1908 shekulli XIX i kishte acaruar akoma më tepër kundërthëniet midis shteteve imperialiste të Evropës, që kishin ndikim të madh edhe në situatatë politike të shqiptarët. Në lëvizjen kryengritëse në Vilajetin e Kosovës shqiptarët bënë kryengritje të vazhdueshme me qëllim që të fitojnë autonomi kulturore, ekonomike dhe politike. Të gjitha këto kryengritje u shuan me gjak. Në vitin 1908 ndodhi revolucioni xhonturk të cilin shqiptarët e përkrahën në fillim, në qoftë se Porta e Lartë u premtoi autonomi, zvogëlim të taksave dhe pavarësimin e kushteve të jetesës kjo shkaktoi protesta, pakënaqësi dhe kryengritje të shqiptarëve në Vilajetin e Kosovës. Konfliktet e para kanë shpërthyer në rrethine Gjakovës më 1909, pastaj kryengritja e shqiptarëve me përmasa më të gjera filloi në pranverë të vitit 1910.

Vilajetin e Kosovës 1908-1912, revolucionin xhonturk dhe rolin e shqiptarëve në shekullin XX. Perandoria Osmane ishte dobësuar si në pikëpamje ekonomike, ashtu edhe në atë politike. Ajo ishte shndërruar në shtet gjysmëkolonial. Si zotërues i shtetit paraqitet kapitali i huaj. Porta ka pasur të nënshkruar disa konventa (kapitulacione) tregtare me vendet kapitaliste të Evropës. Fillimi i formimit organizativ të lëvizjes turke ndihet në vitin 1889, kur në Stamboll ishte formuar komuniteti ilegal politik “*Bashkim dhe përparim*”. Konfliktet në mes të shqiptarëve dhe xhonturqve, marrëveshja që ishte arritur midis shqiptarëve dhe turqve të rinj para revolucionit xhonturk nuk zgjati shumë meqenëse nuk ishte e bazuar në marrëdhënie të sinqerta. Turqit e rinj kishin për qëllim ta shfrytëzojnë fuqinë luftarake të popujve të robëruar kundër absolutizmit të sulltan Hamitit, për përmbysjen e rendit të vjetër dhe për marrjen e pushtetit në duart e tij. Te kryengritja shqiptare në Vilajetin e Kosovës gjatë viteve 1910, metodat e ndryshme që i përdorën turqit e rinj për ta shtypur lëvizjen kombëtare dhe për t’i çarmatosur nuk patën sukses.

kryengritjen e përgjithshme shqiptare gjatë vitit 1912. Situata politike në Vilajetin e Kosovës në prag të kryengritjes së përgjithshme gjatë verës së vitit 1911 qeveria turke me të gjitha përpjekjet që bëri nuk mundi ta shtypte lëvizjen shqiptare, as me forcë ushtarake e as me bisedime e premtime të rrejshme, si ka qenë mësuar ajo. Në Gjakovë kryengritësit e kishin sulmuar burgun dhe i kishin liruar të burgosurit më 16 korrik 1911, të gjitha këto momente flasin për situatën në Vilajetin e Kosovës, për shkallën e shqetësimeve që zhvilloheshin në këto vise. Fillimet dhe sukseset e kryengritjes së përgjithshme, sukseset e kryengritësve në Kosovë i dhanë një shtytje të mëtejshme Lëvizjes kombëtare në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, forcuan gatishmërinë e popullsisë së tyre për t'u hedhur në kryengritje të armatosur. Ndërkohë forcat kryengritëse në Kosovë u hodhën në sulm për çlirimin e qyteteve. Pasi kishin çliruar Gjakovën më 17 korrik, kryengritësit të udhëhequr nga Hasan Prishtina e Bajram Curri iu drejtuan Prishtinës. Çlirimi i Kryeqendrës Vilajeti i Kosovës – Shkupi për të shtuar presionin mbi qeveritarët xhonturq që po vononin përgjigjen në kërkesat e shtuara, udhëheqësit e kryengritjes me pasuritë e tyre marshuan në drejtim të qytetit të Shkupit dhe bëhet e ditur se midis 12 dhe 15 gushtit në Shkup ndodheshin 12.00 shqiptarë të armatosur. Ngjarjet e vitit 1912 janë pika kulmore e të gjitha luftimeve të shqiptarëve që nga viti 1878. Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 shënoi fillimin errënit të sundimit të turqve të rinj në Ballkan dhe hapin vendimtar të shqiptarëve drejt pavarësisë, të cilin hap do ta pengojë me tërë forcën e shteteve ballkanike që tashmë ishte kompletuar dhe kishte shpallur si të drejtë të saj “*legjitime*” ndërhyrjen kundër zotërimeve turke në Ballkan. Fillimi i bisedimeve midis Hasan Prishtinës dhe delegacionit osman në Shkup, ku luftëtari dhe diplomati më i spikatur i çështjes kombëtare këto veprime arriti t'i materializojë skajshmërisht suksesshëm. “*Marrja e Prishtinës*” do të shprehej ai në kujtimete tij na lëshoi në dorë krejt Vilajetin e Kosovës. Kosova në luftën e parë ballkanike na bije në sy për zhvillimet që është fushata shumë e suksesshme e ushtrive ballkanike të cilat brenda një kohe të shkurtër arritën t'i shpartallonin ushtritë turke në të gjitha frontet dhe të depërtonin pothuaj nga të gjitha drejtimet në territoret ballkanike, të cilat aktualisht mbaheshin të pushtuara nga *Perandoria Osmane*. Vetëm brenda 3-4 javëve të para të luftës *ushtria serbe* pushtoi gjithë *territorin e Kosovës, Sanxhakun e Jeni Pazarit dhe një pjesë të Maqedonisë*.

